




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.02.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3047/13, për z. Sylejman Klinaku – Anëtar i Bordit të Ankesave në Komisionin e Pavarur për Media, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-3047/13, për zyrtarin e lartë z. Sylejman Klinaku – Anëtar i Bordit të Ankesave në Komisionin e Pavarur për Media, dhe njëkohësisht avokat dhe person i autorizuar në biznesin privat D.P.SH. “Albi”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Klinaku, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim, ai ka konfirmuar se ushtron funksionin e Anëtarit të Bordit të Ankesave në Komisionin e Pavarur për Media, është avokat dhe po ashtu person i autorizuar në biznesin e lartpërmendur.

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do të pezulloj ushtrimin e profesionit të avokatit deri në përfundim të mandatit, ndërsa për biznesin privat "Albi", ka premtuar se do të caktoj një person të besueshëm për ta udhëhequr këtë kompani.

Ndërkohë, z. Klinaku, ka dërguar në Agjenci kërkesën për pezullimin e përkohshëm të profesionit të avokatisë dhe informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve (DPKI 03-3659/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka autorizuar një person të besueshëm në biznesin privat.

Pas kësaj, Agjencia ka marrë informacionin zyrtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës se z. Klinaku i është aprovuar kërkesa për pezullimin e ushtrimit të profesionit të avokatit deri në kohëzgjatjen e emërimit publik.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

